DRIVE
with us

PORSCHE
ALBANIA

12/10

Porsche Albania Feston 5 Vjet Sukses në Shqipëri
Porsche Albania celebrates 5 years of success in Albania *Page 6*
Më mirë një mekanik se një thesar
He who finds a mechanic finds a treasure *Page 22*
'Die Zukunft' – E Ardhmja
'Die Zukunft' – The Future *Page 24*

Përmbajtja - Contents

▶ 03 **TË DASHUR LEXUES** - DEAR READER

▶ 04 **PORSCHE HOLDING**

▶ 05 **PORSCHE ALBANIA**

▶ 06 **PORSCHE ALBANIA FESTON 5 VJET SUKSES** - PORSCHE ALBANIA CELEBRATES 5 YEARS OF SUCCESSES

▶ 08 **PORSCHE ALBANIA NË SHQIPËRI** - PORSCHE ALBANIA IN ALBANIA

▶ 09 **2 VJET PORSCHE ALBANIA** - 2 YEARS PORSCHE ALBANIA

▶ 10 **KATËR VJET NË TREGUN SHQIPTAR** - FOUR YEARS IN THE ALBANIAN MARKET

▶ 11 **SOT 5** - TODAY 5

▶ 12 **AUTO EMOCION**

▶ 13 **VW MAKINA TREGTARE NË PORSCHE ALBANIA** - VW COMMERCIAL VEHICLES AT PORSCHE ALBANIA

▶ 16 **101 VJET PROGRES NËPËRMJET TEKNOLOGJISË** - 101 YEAR PROGRESS THROUGH TECHNOLOGY

▶ 20 **THJESHT E ZGJUAR** - SIMPLY CLEVER

▶ 22 **MË MIRE NJË MEKANIK SESA NJË THESAR** - HE WHO FINDS A MECHANIC FINDS A TREASURE

▶ 24 **DIE ZUKUNFT - E ARDHMJA** - DIE ZUKUNFT - THE FUTURE

Revista Drive është një botim periodik i Porsche Albania.

Realizimi: Botues Porsche Albania, Realizimi grafik: DDB Albania,

Burimi: Audi: Audi-Mediaservice.com,

SEAT: media.seat.com,

VW Makina Tregtare: volkswagen-media-services.com,

Skoda: press.skoda-auto.com.

Servisi: Database i Porsche Albanias.

Për komente, pyetje apo sygjerime ju lutem na kontaktoni në office@porsche.al ose në numrin e telefonit: +355 (0) 48 20 29 70.

Porsche Albania, Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 3, Mëzez. Telefon: +355 (0) 48 20 29 70, Fax.: +355 (0) 48 20 29 73, e-mail: office@porsche.al http://www.porsche.al

Të dashur lexues,

Ky është botimi i parë i revistës periodike të Porsche Albanias “Drive”. Në këtë numër të parë do të donim të ndanim me ju historinë tonë në këto 5 vite në tregun Shqiptar. Në faqet në vijim do të gjeni informacion mbi Porsche Albania-n, markat tona dhe aktivitetet e organizuara në këto pesë vjet në Shqipëri.

Viti 2010 mbart për ne një rëndësi të veçantë për disa prej markave tona. 101 vjet më parë August Horch krijoi një markë e cilat sot ka arritur majat e segmetit ‘Premium’ në industrinë e makinave luksoze. Janë 101 vjet “Vorsprung durch Technik” (Progres nëpërmjet Teknologjisë) që kanë dhënë zhvillime të pallogaritshme në fusha të ndryshme si teknologjia Quattro apo përdorimi i formave të lehta të aluminit në shasitë e makinave. Gjatë këtij viti u prezantuan tri modele të reja nga shtëpia Gjermane e prodhimit të makinave Audi. Audi A8, Audi A1 dhe Audi A7. Dy prej këtyre modeleve përkatësisht Audi A1 dhe Audi A7 vijnë si risi në segmetet e tyre. “Vorsprung durch Technik” (Progres nëpërmjet teknologjisë) do të vazhdojë të drejtoj përpjekjet e Audit për të ofruar më të mirën në segmentin premium.

SEAT prezantoi SEAT Alhambra e cila vjen tashme me një dizajn dhe teknologji të re. Një dinamikë e përmirësuar drejtimi dhe dizajn frymëzues mbeten tiparet dalluese të këtij modeli.

Škoda ka zgjeruar më tej gamën e modelit të suksesshëm Yeti. Ky model e rendit Škoda-n ndërmjet markave më të mira në segmentin SUV.

VW Makina Tregtare ripërcakton standarded tashmë edhe në segmentin ‘pick up’ me VW Amarok. Në faqet në vijim ju mund të zbuloni më tepër për këto dhe shumë aktivitete të tjera që kemi patur rastin të organizojmë apo marrim pjesë me një ose më shumë marka të tjera.

Së fundi dua t’ju uroj të gjithëve “Gëzuar Krishtlindjet dhe Vitin e Ri”.

Lexim të mbarë.

Dorian Mehmeti
Drejtor Marketing Porsche Albania

Dear Readers,

This is the first issue of the periodical Porsche Albania’s magazine “Drive”. In this first publication we like to share with you our 5 years history in the Albanian market. In the upcoming pages you will find some information about Porsche Albania, our brands and activities in these five years in Albania.

2010 bears special importance for some brands of ours. 101 years ago, August Horch created a brand that has climbed on top of the Premium segment in the luxury cars industry. These 101 years of “Vorsprung durch Technik” (Progress through technology) have generated inestimable developments in various fields such as Quattro technology or the manufacturing of vehicle chassis with light aluminum frame. This year we launched three new models of the German manufacturer Audi. Audi A8, Audi A1 and Audi A7. Two of these, Audi A1 and Audi A7 represent a novelty in their segments. “Vorsprung durch Technik” will continue to lead Audi efforts in offering the best choice in the premium segment.

SEAT has launched the new SEAT Alhambra with totally new design and technology for the whole family to enjoy. Improved driving performance and inspirational design are the trade mark of this new model.

Škoda has extended the successful Yeti rage with new engines. The successful model has places Škoda among the best brands in the small SUV segment.

VW Commercial Vehicles redesigned standards in the pick-up line with VW Amarok. The next pages provide more details on these brands, and on many events we organized or participated in with one or more other brands.

To conclude I would like to wish You a Merry Christmas and a Happy New Year.

Enjoy.

Dorian Mehmeti
Marketing Director Porsche Albania

1 Zyrat qëndrore të Porsche Holding Group në Saltzburg, Austri
Porsche Holding Group headquarters in Saltzburg, Austria

Kompania jonë nënë

Grupi Austriak Porsche Holding është një ndër shoqëritë tregtare më të mëdha në Austri dhe një ndër më të suksesshmet në tregëtinë e automjeteve në Europë. Ka përfaqësi në 17 vende të ndryshme në Europë dhe është e pranishme edhe në Kinë.

Kjo sipërmarrje private është themeluar në vitin 1947 nga dy fëmijët e Ferdinand Porsche – Louise Piëch and Ferry Porsche. Markat e Porsche, Audi, SEAT, Skoda, Bentley, Lamborghini dhe Bugatti përbëjnë portofolin e markave të kompanisë.

Aktiviteti i shitjes është një pjesë e rëndësishme e biznesit falë edhe rrjetit të mirëstrukturuar të shpërndarësve si dhe standardeve të larta në shitje dhe shërbimet pas shitjes. Për vitin fiskal 2009/2010 grupi Austriak ka shitur 420,824 mjete dhe ka siguruar një xhiro prej 12.2 miliard Eurosh. Zyrat qëndrore janë në Salzburg, Austri dhe për vitin fiskal 2009/2010 punëson 20,299 punonjës.

Our mother company

Austrian Porsche Holding is one of the biggest trade companies in Austria, and one of the most successful in the car market in Europe. It has representatives in 17 different countries in Europe and it is also present in China.

This private enterprise has been founded from the two children of Ferdinand Porsche – Louise and Ferry Porsche. The trademarks of Porsche, Audi, SEAT, Skoda, Bentley, Lamborghini and Bugatti constitute the portfolio of the company's trademarks.

The sales activity is an important part of the business, thanks to the well-established network of distributors and the high standards in sales and after sales services. For the fiscal year 2009/2010, the Austrian Group has sold 420,824 cars with a profit of 12.2 billion euros. The headquarters are in Salzburg and employs 20,299 people.

2 Porsche Albania në autostratën Tiranë - Durrës
Porsche Albania in Tirana - Durrës highway

Porsche Albania

Ka hyrë në tregun Shqiptar në vitin 2005 si investim direkt i Porsche Holding në Shqipëri me një vizion të qartë për të sjellë eksperiencën e Porsche Holding në fushat e komunikimit, shitjes dhe shërbimeve pas shitjes. Të sjellësh më të mirën e asaj çka një ndër grupet më të mirë në Europë kanë për të ofruar është shumë më tepër se një slogan për Porsche Albanian.

Në vitin e parë të aktivitetit janë prezantuar dy marka: Audi dhe SEAT. Një vit më vonë marka Çeke e prodhimit të makinave Skoda i shtohet portofolit të markave të kompanisë. Në janar 2008, Porsche Albania merr të drejtën për të tregëtuar VW Makina Tregtare duke i ofruar klientëve të saj një model për çdo kërkesë të tyre.

Çdo tipar i punës është i orientuar nga klienti. Logjistika është një prej tyre, falë kordinimit me kompanive Porsche ne rajon është e mundur që të ulen kohët e porositjes dhe dorëzimit të makinave.

Porsche Albania

Entered the Albanian market in 2005 as a direct investment of Porsche Holding in Albania, with a clear vision of bringing the experience of Porsche Holding in the fields of communications, sales and after-sales services. Bringing the best of what one of the best groups in Europe has to offer is much more than just a slogan to Porsche Albania.

Audi and SEAT were launched in the first year of activity. The year later, the Czech brand Skoda joined the company portfolio. In January 2008, Porsche Albania was granted the rights to market VW Commercial Cars, offering clients a model to any demand.
Each line of work is consumer-oriented, logistics being one of them. Proper coordination with Porsche companies in the region results in lower lead times for orders and delivery of cars.

3 Portofoli i markave të Porsche Albania përgjatë viteve
Porsche Albania's brand portfoglio through the years

Porsche Albania Feston 5 Vjet SuksES në Shqipëri

(intervistë me Drejtorin e Përgjithshëm Z. Gentian Bushati)

5 vjet Porsche Albania. Çdo të thotë kjo për Porsche Albania-n dhe tregun Shqiptar?

G.B: Thuhet se numri pesë mbart një forcë të mistershme. Në mitologjinë e Lindjes së largët pesë janë forcat fillestare: Shpirti, Ajri, Zjarri, Uji dhe Toka. Pesë janë shqisat të cilat na ndihmojnë të perceptojmë botën përreth nesh, shqisa të cilat ne i përdorim për të njohur tregun ku operojmë.

Për Porsche Albania-n numri 5 kurorëzon pesë vitet e aktivitetit në tregun Shqiptar. Një aktivitet i cili filloi vetëm me 2 marka (Audi dhe SEAT) ne fund vitin 2005 dhe shitje fare modeste për të mbërritur në këtë ditë kur Porsche Albania renditet si kompania më e madhe si për nga numri i makinave të dorëzuara tek klientët për të katërta markat tona Audi, SEAT, Skoda dhe VW Makina Tregtare, si për nga ajo çka është edhe më e rëndësishme: besueshmëria që kemi fituar tek klientët tanë.

Unë jam i mendimit se janë dy faktorët që kanë bërë të mundur suksesin e deritanishem të cilat vlen t'i ndajmë së bashku: orientimi i vazhdueshëm ndaj klientit me standarded më të larta në çdo proçes të punës dhe si dhe puna e palodhur e një ekipi profesionist, të cilët janë realisht avantazhi ynë konkurrues në një mjedis kaq dinamik siç është edhe tregu i makinave.

Tashmë Porsche Albania është bërë një zgjedhje e parë në rastin e blerjes së një makine të re.

Si ishte rruga në këto 5 vite aktivitet të Porsche Albania-s në Shqipëri?

Unë besoj se këto 5 vite ne kemi bërë shumë që kompania jonë të jetë një ndër aktorët kryesorë në tregun automobilistik Shqiptar.

E filluam me dy marka, Audi dhe SEAT pastaj në mesin e vitit 2006 portofolit tonë iu shtua marka Skoda dhe nga fillimviti 2008 Porsche Albania ka pjesë të portofolit të saj dhe markën Volkswagen Makina Tregtare. Këto marka bëjnë të mundur që portofoli i markave tona të mbulojë 4 segmentet kryesore të tregut automobilistik në Shqipëri.
Investuam kapitale financiare, investuam në burime njerëzore dhe në kapacitet profesionale të stafit tonë të shitjes dhe të servisit.

Kemi prezantuar vetëm në dy vitet e para më shume se 33 modele makinash të markave SEAT, Skoda dhe Audi vazhduam me modelet e Volkswagen Makina tregtare, të gjitha këto marka pjesë të Grupi Volkswagen.
Duke patur në qendër të biznesit tonë konsumatorin, orientuam aktivitetet tona të marketingut, shitjes dhe të servisit në një situatë përfitim reciprok. Të gjitha këto hapa dhe strategji, kanë bërë të mundur që sot Porsche Albania të jetë kompania lider në tregun automobilistik Shqiptar.

Sa ka ndikur kriza e përgjithshme financiare në qëndrimin e klientëve Shqiptarë ndaj makinave të reja, rrjedhimisht dhe në rezultatet e Porsche Albania-s?

Pa dyshim që viti 2009 (kur kriza financiare që mbërtheu botën njohun edhe pikun e saj) ishte i vështirë për të gjithë

Porsche Albania celebrates 5 years of success in Albania

(interview with Mr. Gentian Bushati, General Manager, Porsche Albania)

5 years Porsche Albania. What does it mean for Porsche Albania and the Albanian market?

G.B: It is said that number five bears a mysterious force. Far East mythology indicated five inception forces: Spirit, Air, Fire, Water and Earth. Five as the senses that help us perceive the world, and that we use to know the market we operate in.

Number 5 for Porsche Albania represents five years of activity in the Albanian market. It started in late 2005 with only 2 brands (Audi and SEAT) and rather modest sales, but evolved into the biggest company in terms of cars delivered to clients and most importantly, built-up clients trust.

In my opinion, two factors enabled this success: constant client-driven orientation applying high standards in any line of work, and the tireless work of a professional team who really makes our competitive advantage in highly dynamic environment as the auto market.

Now, Porsche Albania is the first choice whenever people want to buy a new car.

What were these 5 years like to Porsche Albania?

I believe we have done a lot in these 5 years to ensure that our company becomes a key player in the Albanian auto market.

We invested in financial capital, in human resources and professional capacity of our sales and service staff.

In the last two years, we have presented over 33 car models of SEAT, Skoda and Audi and then the VW Commercial Cars, all these brands as part of Volkswagen Group.

Having the consumer as the focal point of our business activity, we oriented our marketing, sales and service activities towards win-win relationships. All these steps and strategies have made Porsche Albania a leader company in the Albanian auto market today.

Did the global financial crises have an impact on the behaviour of Albanian clients towards new cars and therefore on the results of Porsche Albania?

Naturally, 2009 (when the financial crises took a firm grip on the world and reached its peak) was a difficult year for all the operators. However, in such a situation, the best strategy is to rely on the basic values on which we established our business model.

The reality proved us right. Porsche Albania managed to increase (although slightly) its sales even in the difficult conditions of 2009, compared to the previous year. Maintaining and consolidating the company position at a time when the whole market suffered setbacks, this means a lot to us...

Looking at the chart of cars delivered to our clients throughout these 5 years of activity, the year-on-year increase for Porsche Albania is really striking (including 2009). For 2010, we promised to our business partners that we would exceed the threshold of 600 cars delivered to our clients. At the end of this year, it gives us enormous satisfaction to see that this benchmark was met and the promised kept.

How was the 5th anniversary celebrated and how did the

operatorët në treg. Megjithatë ne besojmë se në një situatë të tillë strategjia më e mirë është të mbështetesh në vlerat bazë mbi të cilat është ndërtuar modeli i biznesit që kompania jonë ka krijuar.

Realiteti provoi se kishim të drejtë. Porsche Albania arriti që edhe gjatë vitit të vështirë 2009 të kishte rritje (edhe pse te vogël) në krahasim me shitjet e një viti më parë. Të ruash dhe forcosh pozitën e kompanisë në një kohë kur i gjithë tregu po njeh vetëm rënie, kjo për ne do të thotë shumë…

Nëse shohim grafikun e makinave të dorëzuara tek klientët përgjatë 5 viteve të aktivitetit, gjëja e parë që vërehet është pa dyshim rritja që Porsche Albania ka njohur vit pas viti (përfshirë këtu edhe vitin e vështirë 2009). Në fillim të vitit 2010, ne u premtuam të gjithë bashkëpunëtorëve tanë se do ta kalonim për herë të parë kufirin e 600 makinave të dorëzuara tek klientët. Në fund të vitit konstatojmë me kënaqësi se kufirin e kaluam, pra e mbajtëm premtim.



1 Makina të dorëzuara nga Porsche Albania tek klientët gjatë viteve
Porsche Albania vehicles delivered to customers through the years

Si është festuar ky 5 vjetor në Shqipëri, dhe si u prit nga të ftuarit?

G.B. Ne donim që 5 vjetori t'i shpëtonte rutinës së një festimi të zakonshëm. Donim që të ftuarit të përjetonin në këtë mbrëmje më tepër sesa thjesht historikun e Porsche Abania-s. Une besoj që kjo u arrit. 5 vjetori ishte një mbrëmje madhështore festive midis miqsh të Porsche Albania-s dhe përfaqësuesve të institucioneve të ndryshme dhe trupit Diplomatik të akredituar në Tiranë. Gjithashtu, për herë të parë, njëkohësisht me tregjet më të zhvilluara të Europës Porsche Albania prezantoi tre modele te reja. Tashmë publiku Shqiptar mundi të shihte premierën e VW Amarok, VW Caddy GP dhe Audi A1 njëkohesisht me tregjet më të zhvilluara të perëndimit madje në disa raste edhe para disa prej këtyre tregjeve.

Festimi i pesëvjetorit të Porsche Albania-s në Shqipëri shkoi përtej një mbrëmjeje festive. Në dt. 8 Tetor (pra të nesërmen e aktivitetit) Porsche Albania organizoi për herë të parë ekspozitën e markave të saj në Pallatin e Kongreseve në Tiranë. Për tri ditë klientët, miqtë dhe partnerët tanë të biznesit patën rastin të shohin por edhe të përfitojnë nga ofertat absolutisht më të mira të tregut. Kjo ishte mënyra jonë për t'u thënë 'Faleminderit' të gjithëve miqve tanë për bashkëpunimin e deritanishëm.

A mbarojnë këtu risitë për këtë vit?

G.B Absolutisht jo. Prezantimet vazhdojnë më tej me modelin luksoz Audi A7 i cili thekson edhe më tepër tiparet e markës me katër rrathë. Një model tërësisht i ri për të gjithë ata që nuk duan të bëjnë kompromis midis luksit dhe performancës.

Shtëpia spanjolle SEAT, prezanton SEAT Alhambra-n, e cila vjen tashmë tërësisht e rikonceptuar dhe mbart të gjithë dinamizmin e markës spanjolle.

Po viti 2011? Çfarë pritet përsa i përket modeleve të reja?

Vitin e ardhshëm, do të prezantohen një gamë e re modelesh të cilat plotësojnë segmentet e tregut deri tani të pambuluara nga markat tona. Vlen të përmendim modelet e reja të shtëpive spanjolle dhe çeke (SEAT dhe Škoda) të cilat do të prezantojnë secila versionin e tyre në segmentin A00.

Audi do të ri-sjellë në segmentin premium modelin e ri Audi A6 (C7), por surprizat nuk do mbarojnë këtu për këtë markë. Fundviti 2011 do të ketë një model surprizë nga marka e katër rrathëve. VW Makina Tregtare do të sjellë modelin e ri në një nga segmentet që po njeh vetëm rritje në tregun tonë.

Pra siç e shikoni, ne do të vazhdojmë të jemi gjerësisht prezent me modelet tona edhe në vitin 2011. Do të vazhdojmë të investojmë që kompania jonë të jetë një nga kompanitë më atraktive përsa i përket punësimit në vendin tonë.

Në fund të kësaj interviste, më lejoni që në emër të Porsche Albania-s t'u uroj të gjithë lexuesve dhe stafit të Porsche Albania-s: Gëzuar Krishtlindjet dhe Vitin e Ri 2011. Uroj që të jetë një vit i mbarë për të gjithë.

Faleminderit për intervistën.

invitees expect it?

G.B. We wanted the 5th anniversary to be unlike a routine celebration. We wanted invitees to feel this evening rather than simply the history of Porsche Albania. I believe that we succeeded in that. The 5th anniversary was a magnificent evening among friends of Porsche Albania and representatives of various institutions and diplomatic corps accredited in Tirana. The novelty was that Porsche Albania presented three new models, simultaneously with the most developed European markets. The Albanian public had the chance to watch the premiere of VW Amarok, VW Caddy GP and Audi A1 at the same time with the most developed Western markets and in some cases even before some of them.

Celebrations of the 5th year of Porsche Albania went further than a festive evening. On 8 October (the day after the activity), Porsche Albania organized its first exhibition of its brands in the Palace of Congresses in Tirana. For three days, our clients, friends and business partners had the opportunity to see and even take advantage of some absolutely best offers available in the market. This was our way of saying "Thank you" to all our friends for their cooperation so far.

This means that nothing new is to be expected anymore for this year?

G.B Absolutely not. Presentations will continue with the luxury model Audi A7 which exuberates the features of the four-circle brand; an entirely new model for anyone that makes no compromise between luxury and performance.

The Spanish House SEAT will come with SEAT Alhambra completely redesigned and embodying all the dynamism of the Spanish brand.

What about 2011? What new models will be launched?

For next year, it is expected a new range of models which will fill the gaps in the market segments still not covered by our brands. It must be noted that the Spanish and Czech houses (SEAT and Škoda) will present their version in the segment A00.

Audi will re-launch the new model Audi A6 (C7) in the premium segment, but more surprises are to be expected from this brand. The late 2011 will see a surprise model from the four-circle brand. VW Commercial Cars will bring a new model in one of the segments that is only thriving in our market.

As you can see, we will continue to be extensively present with our models in 2011, too. We will keep up investing so that our company remains attractive to employment in our country.

On behalf of Porsche Albania, allow me to wish the readers and staff of Porsche Albania: "Merry Christmas and a Happy New Year. I wish this is a most successful year for you all!"

Thank you for the interview.

Porsche Albania në Shqipëri

Prezantimi i Porsche Albanias ne tregun Shqiptar

Konferenca e prezantimit të Porsche Albanias në Shqipëri. Audi dhe SEAT tashmë përfaqësohen zyrtarisht në tregun Shqiptar. Teknologjia Gjermane dhe emocioni Spanjoll në dizajn tashmë në një shtëpi.

Porsche Albania in Albania

Presentation of Porsche Albania in the domestic market

Presentation conference of Porsche Albania. Audi and SEAT are now officially represented in the Albanian market. German technology and Spanish emotion in design share the same roof.

Wout van Parys
Drejtor Rajonal Shitjesh Audi
Audi Regional Manager

Wolf Dieter Hellmaier
Drejtor Boardi Austrian Porsche Holding Group.
Board Director Porsche Holding Group

Alex Vaszi
Drejtori i parë i Përgjithshëm i Porsche Albania-s
First General Manager of Porsche Albania

Ditëlindeja e parë e Porsche Albania

Në vitin e parë në treg, Porsche Albania solli dy markat Audi dhe SEAT si dhe një numër të madh modelesh për klientët Shqiptar.

Në ceremoninë e organizuar me rastin e 1 vjetorit të hyrjes në treg Porsche Albania prezantoi dy modelet SEAT Leon dhe Audi A6 për të gjithë klientët, miqtë dhe bashkëpunëtorët e saj.

Porsche Albania first birthday

At its first year in the Albanian market Porsche Albania has brought two brands (Audi and SEAT) and a number of models for the Albanian clients.

At its first anniversary Porsche Albania introduced for all its clients, friends and business partners two new models SEAT Leon and Audi A6.

2 Vjet Porsche Albania

Një natë emocionesh të forta, me prezantimet e tri modeleve më të reja për secilën markë. Audi A5, Skoda Octavia RS dhe SEAT Altea Freetrack debutuan para publikut Shqiptarë në dy vjetorin e Porsche Albania në Shqipëri. I organizuar si një takim mes miqsh ky aktivitet u mbyll me një surprizë për të gjithë të apasionuarit e makinave. Modelet më sportive dhe luksoze si Lamborghini Gallardo Superleggera, Bentley Continental Flying Spur dhe Audi R8 u ekzpozuan eksluzivisht për të ftuarit e këtij aktiviteti.

2 Years of Porsche Albania

A night of intensive emotion, with the presentation of three latest models for each brand: Audi A5, Skoda Octavia RS and SEAT Altea Freetrack made their debut to the Albanian public during the 2nd anniversary of Porsche Albania in the domestic market. Conceived as a meeting among friends, the event closed with a surprise for all car fans. Most luxurious and sports models like Lamborghini Gallardo Superleggera, Bentley Continental Flying Spur and Audi R8 were exhibited exclusively for the guests.

Katër vjet në tregun Shqiptar

Prezantimi i Skoda Yeti dhe SEAT Exeo.

Gjatë 4 vjetorit të Porsche Albania-s, u prezantuan dy modelet e reja nga shtëpitë Çeke Skoda dhe ajo Spanjolle SEAT. Të ftuarit patën rastin për të parë për herë të parë këto dy modele.

Four years in the Albanian market

Presentation of Skoda Yeti and SEAT Exeo.

The 4th anniversary of Porsche Albania culminated with the presentation of two new models Skoda YETI and SEAT Exeo from the Czech and Spanish manufacturers. The guests had the chance to see these models for the first time.

Sot 5

(Audi A1 dhe VW Amarok ndërmjet të ftuarve special në 5-vjetorin e Porsche Albania-s.)

Premiera e dy modeleve Audi A1 dhe VW Amarok në pallatin e kongreseve, përkoi jo vetëm me 5 vjetorin e hyrjes në tregun Shqiptar të Porsche Albania-s por edhe me premierën botërore të këtyre dy modeleve. Festimi i pesë vjetorit ishte një mbrëmje e veçantë dhe me shumë surpriza për të gjithë të ftuarit. Makina, muzikë dhe një bisedë mes miqsh alternativa më e mirë për një të Enjte pasdite.

Today 5

(Audi A1 and VW Amarok among the special guests in the 5th anniversary of Porsche Albania.)

The premiere of Audi A1 and VW Amarok in the Palace of Congresses coincided both with the 5th anniversary of Porsche Albania in the Albanian market and with the world-wide premiere of these two models. The fifth anniversary celebration was an evening with many surprises. Cars, music and a chance to get together with friends were the best alternatives to a Thursday evening.

Ekspozita e markave të Porsche Albanias

Në pesë vjetorin e hyrjes në treg Porsche Albania organizoi ekspozitën me të gjitha markat e saj. Vizitorët patën rastin të shohin nga afër Audi A1 dhe VW Amarok për herë të parë në Shqipëri.

Porsche Albania brands exhibition

During its fifth year in the market, Porsche Albania organized a fair with all of its brands that are traded. Visitors had the chance to see from up close for the first time in Albania the Audi A1 and VW Amarok.

Auto Emocion

Shën Valentini me SEAT

E kthyer tashmë në një traditë, Shën Valentini me SEAT ka ofruar çdo vit një risi. Transmetimet maratonë SEAT në Club FM, dhuratat në rrugë, zyra apo qëndra tregtare, party-t e organizuar në MAD Club si dhe koreografi të realizuara me makina në rrugët e Tiranës e kanë kthyer SEAT në një simbol të kësaj feste.

Saint Valentine with SEAT

Loyal to tradition, SEAT offers a novelty each Saint Valentine. Marathon broadcasting of SEAT on Club FM, delivery of presents on streets, offices or malls, parties organized in MAD Club and particularly choreographies with cars around the streets of Tirana, have made SEAT a symbol of this day.

SEAT on air

Të lodhur pas një dite të ngarkuar por me arritje në punë? Në Club FM SEAT ju dedikon muzinën më të mirë për pak energji dhe shplodhje.

Cdo ditë nga ora 16:00 deri në 18:00 SEAT në Club FM ju uron një pasdite të këndshme me tingujt më emocionues që pasditja mund t'ju ofroj.

SEAT on air

Feel tired of a busy but efficient day at work? Club FM SEAT offers the best music to relax and build up energy.

Every day from 16:00hrs to 18:00hrs SEAT on Club FM wishes you a pleasant evening with the most heart-felt tunes.

SEAT Altea Freetrack

U prezantua për herë të parë në tregun shqiptar gjatë dy vjetorit të Porsche Albania në Nëntor 2008. Një makinë sa sportive aq edhe luksoze. SEAT Altea Freetrack makina ideale për të gjithë ata që kërkojnë emocine të forta si në qytet ashtu edhe në natyrë. 200 kuajt fuqi në motorrin 2.0 TSI i japin modelit tiparet e përsosura për makinë familjare apo biznesi.

SEAT Altea Freetrack

Launched in the Albanian market on the occasion of the 2nd anniversary of Porsche Albania in November 2008. A combination of sportive performance and luxurios. SEAT Altea Freetrack the perfect vehicle for those that are looking for strong emotions whether in city or in the nature. 200 horse power and the 2.0 TSI engine make it a perfect family or business car.

VW makina tregtare në Porsche Albania

Vetëm tre vjet pas hyrjes në treg, Porsche Albania shton në portofolin e markave të saj Volkswagen Makina Tregtare. Që nga 1 Janari i 2008 Porsche Albania ofron gamën më të plotë të mjeteve për çdo segment kryesor të tregut. "Marrja e të drejtës për të tregtuar një nga dy markat e Volkswagen na shton besimin se tashmë, me gamën e markave tona, mund ti përgjigjemi më mirë të gjitha kërkesave të klientëve për transport, luks, makinë ekonomike apo me shumë emocion në timon" thotë Drejtori i Përgjithshëm në Porsche Albania Z. Gentian Bushati. U deshën vetëm pak muaj që shitjet në Porsche Albania të tejkalonin pritshmëritë fillestare që fabrika Volkswagen kishte për tregun shqiptar. "Besimi që klientët tanë patën tek ne, si dhe eksperienca e Porsche Holding në segmentin e makinave tregtare bëri që niveli i shitjeve për këtë markë të tejkalonte pritshmëritë e fabrikës, duke patur parasysh që në treg prej disa vitesh egzistonte edhe një operator tjetër.

Një punë e jashtëzakonshme është bërë në mënyrë që të zgjerohen dhe përshtaten kapacitetet e servisit. Rëndësi e veçantë i është kushtuar trajnimit të stafit të shitjes dhe atij të servisit, instalimi i programeve për diagnostifikim elektronik dhe vendosja e lidhjeve me serverat e fabrikës. Makina frigoriferike, ambulanca, transport pasagjerësh janë vetëm disa nga kombinimet që ofrohen për të plotësuar nevojat e çdo biznesi për transport. "Komunikimi i vazhdueshëm me klientët tanë, pjesëmarrja nëpër panaire biznesi, kontaktet e vazhdueshme me fabrikën, trajnimet nga ekspertët gjermanë të stafit, si dhe ndjekja e vazhdueshme e tregut na shtojnë bindjen se tek ne në Porsche Albania klientët dhe partnerët tanë të biznesit mund të marrin përgjigjen më të mirë për kërkesat e tyre për transport.

Konsulenca logjistike është hapi tjetër që planifikojmë në Porsche Albania. Optimizimi i transportit shkurton ndjeshëm kostot dhe kohët e lëvrimit duke i dhënë bizneseve një përparësi të prekshme krahasuese në treg." Vazhdon më tej Z. Bushati. Porsche Albania ka zhvilluar në mënyrë të ndjeshme tregun e makinave tregtare në Shqipëri. "Ka qenë komunikimi i vazhdueshëm me klientët tanë që na ka dhënë përparësi ndaj operatorëve të tjerë në treg. Ditët e Hapura, prezantimet e modeleve më reja, pjesëmarrja nëpër panaire biznesi janë vetëm një pjesë e asaj cka na afron me klientët tanë. Në fund të vitit 2010, shohim pas tre vitesh pune intensive për të ofruar në treg atë çka është më e vyer për klientët tanë: "Profesionalizmin", ndërkohë tek hedhim vështrimin përpara shohim një pune me shumë sfida dhe arritje për që qënë zgjedhja e parë në tregun e makinave të reja në Shqipëri." – përfundoi Z. Kozma drejtor i markës VW Makina Tregtare në Porsche Albania.

VW Commercial Vehicles in Porsche Albania

Just three years from entering the market, Porsche Albania expands its brand portfolio with VW Commercial Vehicles. Since 1 January 2008, Porsche Albania has been offering a brand for each of the major market segments. "By acquiring the rights to sell one of the two Volkswagen brands, we feel more confident that with our range of brands we can better satisfy our clients' demand for transport, luxury, economy cars and emotion on the wheel", says Mr. Gentian Bushati, General Manager of Porsche Albania. A few months were enough to bring Porsche Albania sales beyond the initial expectations of the Volkswagen house in the Albanian market. "The clients trust in us and the experience of Porsche Holding in the segment of commercial vehicles contributed to higher-than-expected sales considering that another operator was in the market from some years now".

Extraordinary efforts were made to expand and adapt the service capacity. Due importance was paid to training the sales and service staff, installation of diagnostic scanning programmes and ensuring connection with the factory servers. Refrigerator box, ambulances, passenger transport are just some of the combinations offered to meet the transport needs of any business. "Continuous communication with our clients, participation in business fairs, constant contacts with the factory, training of staff by German experts and careful follow up of the market feed are our convictions that here at Porsche Albania our clients and business partners will find the best match for their transport needs.

"Logistic consultancy is the next step for Porsche Albania. Transport optimization significantly reduces delivery costs and time, giving businesses a considerable advantage over the competition", states Mr. Bushati. Porsche Albania has strongly developed the auto market in Albania. "It was the continuous communication with our clients that gave us the edge over other operators in the market. Open days, presentations of new models, participation in fairs is only a part of what brings us closer to our clients. In these 3 years we worked intensively to offer clients what is more precious, "Professionalism". The coming years bear many challenges and achievements, but also the conviction that we can become first choice in the Albanian auto market", says Mr. Kozma, manager of VW Commercial Vehicles in Porsche Tirana.



1 Konferenca e prezantimit të VW Makina Tregtare në Porsche Albania (Janar 2008)
VW Commercial Vehicles Introduction Conference (January 2008)

2 3 Panairi i bizneseve Gjermane në Tiranë (Maj 2009)
German business fair in Tirana (May 2009)

4 Panairi i biznesit Klik Ekspo (Nëntor 2008)
Klik Expo business fair (November 2008)

5 6 Prezantimi i VW Caddy Maxi (Prill 2008)
Presentation of VW Caddy Maxi (April 2008)

101 vjet progres nëpërmjet teknologjisë

101 years of progress through technology

101 vjet Audi

Tek Audi, progresit të vazhdueshëm teknologjik tashmë i shtohen edhe 101 vite eksperience. Janë 101 vite të mbushura me arritje dhe sfida të realizuara. Një punë e gjatë dhe e palodhur për tu pozicionuar në majën e segmentit ekzekutiv në treg. Një punë e cila është shpërblyer më së miri nga interesi dhe vëmendja e klientëve tanë.

